



Prishtinë: 22.04.2013

Kodi i ZRRE-së: V\_522\_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_910\_02\_13

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_910\_02\_13**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 29.03.2013.

**Në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2013 nxorri këtë:**

### VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Xh. J, (parashtruesi i ankesës Q. J), kundër vendimit të DMK-së.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_910\_02\_13 i datës 28.02.2013.

### Arsyetim

Me datë 22.10.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me kërkesë të konsumatorit kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik numër 16957 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik numër 7027554 si dhe kanë bërë vulosjen e njehsorit.

Me datë 19.02.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 16957 ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi.

Me datë 21.10.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me kërkesë të konsumatorit kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik numër 7027554 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik numër 40863486 si dhe kanë bërë vulosjen e njehsorit.

Pas parashtrimit të ankesës në Departamentin për Konsumator në KEK me datë 29.08.2012 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar si dhe duke u thirrur në përgjigjen e KEK-ut, të dates 29.10.2009.

Konsumatori me datë 24.01.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, DMK ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 28.02.2013 ka nxjerr vendim ku ka **refuzuar** ankesën e konsumatorit me arsyetimin se parashtruesi i ankesës ka qenë bashkëpronar i pronës – shtëpisë dhe krijues të përbashkët i borxhit të energjisë



elektrike, gjithashtu është theksuar se bazuar në mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike si dhe transaksionet e konsumatorit ky konsumator ka pasur faturim të rregullt të energjisë elektrike.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 29.03.2013 parashtruesi i ankesës Q. J. ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Baza e kundërshtimeve të konsumatorit të theksuara në ankesë është për faktin se DMK, gjatë vendosjes së kësaj lënde nuk është vërtetuar gjendja e drejt e çështjes që ka të bëjë sipas vendimit sepse gjendja e prezantuar që ka të bëjë me njehsorin e evidentuar në emër të Xh. J, është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar reale. Kundërshtim tjetër i konsumatorit në ankesë është se kjo çështje është dashtë të vendoset nga gjykata kompetente e jo nga organi që ka nxjerr vendimin.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 22 prill 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara, gjithashtu vlerësimin se për vendosjen e kësaj çështje ka qenë kompetente vetëm gjykata. Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të gjitha pikave të kundërshtimit konstaton se parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se në cilën rrethanë organi i shkallës së parë nuk ka vërtetuar drejt gjendjen reale dhe faktike dhe se në asnjë rast nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë me të cilën e vërteton të kundërtën e asaj se çka është thënë në vendimin e shkallës së parë. Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të hollësishëm të kësaj pike nuk ka gjet ndonjë shkelje që vërteton faktin se vendimi i shkallës së parë nuk është vendim i drejt.

Po ashtu kundërshtim tjetër i parashtruesit të ankesës ka qenë se DMK me rastin e vendosjes nuk ka qenë kompetente pasi që kjo çështje është kompetencë e gjykatës. Bordi i ZRRE-së, konsideron se DMK, ka vepruar drejt dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes së kësaj çështje, pasi që në këtë vendim nuk është shqyrtuar çështja se përgjegjësi e kujt është borxhi i krijuar i energjisë elektrike, por që në vendim është shqyrtuar çështja e borxhit që është krijuar në këtë pikë matëse dhe nga po këta persona. Andaj çdo person që shfrytëzon energjinë elektrike është i obliguar edhe ta paguaj dhe me këtë rast parashtruesi i ankesës është dashtë që të bëjë zgjidhjen e borxhit të krijuar së bashku me vllaun e tij e jo të fshihet mbas emrit të vllahut pasi që njehsori elektrik ka qenë në emër të Xh. J. dhe se parashtruesi i ankesës është tani pronar i kësaj shtëpie.

Bordi i ZRRE-së, konsideron se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore, në rastin e vendosjes së ankesës së konsumatorit me të cilën ka konstatuar se parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi se nuk ka qenë bashkëpronar i kësaj prone me ç'rast e ka refuzuar ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se parashtruesi i ankesës Q. J., në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 22.04.2012 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_910\_02\_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar